

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7194
E premte, 24 maj 2024
Çmimi 0.50 €

Miratohen disa marrëveshje
ndërkombëtare,
përfshirë atë për kreditin
për banimin social



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME: 'PARA VJESHTËS' PO, POR SI?

FACE 4



I duan zgjedhjet e parakohshme, por nuk pajtohen se si të arrijnë deri te to. Partitë opozitare në Kosovë mbeten të ndara. Partia Demokratike e Kosovës pajtohet

që në zgjedhje të shkohet përmes shpërndarjes së Kuvendit, por jo edhe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e

Kosovës, të cilat duan fillimisht dorëheqjen e kryeministrit Albin Kurti. Opsionin e fundit, partia e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje, "nuk e konsideron"

AKTUALE



KOVAČEVSKI JEP DORËHEQJE NGA DREJTIMI I LSDM-së F. 2

BAJRAMI: QEVERITARËT KANË SHPENZUAR MESATARISHT 8 800 EURO NË DITË PËR USHQIM DHE PIJE F. 6

SËRISH DËSHTON VOTIMI I PROJEKTLIGJIT PËR SHËNDETIN RIPRODHUES F. 7

EKONOMI



DEFICITI TREGTAR I KOSOVËS NË PRILL ARRITI NË 12.2 PËR QIND F. 8

PARTNERITETI I KOSOVËS ME SHBA-NË ËSHTË ARMATIMI MË I FUQISËM NË ASPEKTIN E SIGURISË DHE MBROJTJES QË KA KOSOVA F. 8

Shkruan:
Safet GËRKHALIU



SPORT



KUKA: KONFIRMohen PESË NORMA OLIMPIKE PËR XHUDON E KOSOVËS

F. 10

KUVENDI E RATIFIKON MARRËVESHJEN ME DANIMARKËN PËR BURGJET

F. 3



KOZ-ja FILLON PËRGATITJET PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME, NDAN 1 MILION EURO PËR FURNIZIM ME KAMERA PËR VENDVOTIME F. 7

RENOVA
PUTZ
Mogorani
Xhagjiniq - Tetovë
Gurte-Perizaj
Tel: +389 44 487 302 | +389 44 487 929
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Më: +389 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-kc.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYRKOL - BUNJAKOL - CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
018 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SHIRIA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP BILA
DIDA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 10338 246 301 Fax: +381 10338 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kovaçevski jep dorëheqje nga drejtimi i LSDM-së

SHKUP, 23 MAJ - Dimitar Kovaçevski ka njoftuar të mërkurën për dorëheqjen nga pozita e kryetarit të partisë, Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM). Para Këshillit të Përgjithshëm të LSDM-së, Kovaçevski e arsyetoi aktin e dorëheqjes me disfatën e thellë të partisë në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare që u mbajtën më 8 maj. Kandidati i LSDM-së për president, Stevo Pendarovski, u mposht nga Gordana Silanovska-Davkova nga VMRO DPMNE, me një dallim prej 300 mijë votash. Edhe në zgjedhjet parlamentare LSDM-ja pësoi disfatë të thellë duke arritur të marrë vetëm 18 mandate të deputetëve, kundrejt 58 sa fitoi VMRO-ja. "Në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, LSDM-ja pësoi një disfatë, duke marrë një goditje të rëndë jo vetëm nga

qytetarët, por edhe nga simpatizantët, disa nga ryma brenda partisë, disa nga anëtarë të partisë të organizuar në një tjetër subjekt politik", tha Kovaçevski duke kërkuar edhe nga drejtuesit e tjerë të lartë të partisë që të japin dorëheqje. Kovaçevski kërkoi nga organet drejtuese të LSDM-së që të mbahet një kongres, në të cilin do të analizoheshin rezultatet e zgjedhjeve dhe më pas do të mbaheshin zgjedhjet brendapartiake për zgjedhjen e drejtuesve të rinj të kësaj partie. "Hapi i parë në konsolidimin e LSDM-së duhet të jetë rindërtimi i matricës ideologjike dhe vlerave socialdemokrate për t'i bashkuar të gjitha forcat progresive të qendrës së majtë në vend. Hapi i dytë është ndryshimi i thellë kadrovik dhe krijimi i një potenciali të fortë dhe së fundi, reforma në strukturën organizative të



partisë", tha Kovaçevski. Kovaçevski drejtimin e LSDM-së e kishte marrë nga ish-kryeministri i Maqedonisë së

Veriut, Zoran Zaev, i cili dha dorëheqje në vitin 2021 pas disfatës së thellë të kësaj partie në zgjedhjet lokale.

Kovaçevski, po ashtu, ka qenë kryeministër i Maqedonisë së Veriut nga 16 janari i vitit 2022 deri më 25 janar të vitit 2024.

Republika Sërpska ofron marrëveshje për "ndarje paqësore" në Bosnjë-Hercegovinë

SRBENICË, 23 MAJ - Në 30 ditë e ardhshme Qeveria e Republikës Sërpska (RS) do të krijojë një marrëveshje që do t'i dërgohet entitetit tjetër të Bosnjës, Federatës së Bosnjës e Hercegovinës, për "ndarje paqësore", njoftoi kryeministri i RS-së, Radovan Vishkoviç, pas mbledhjes së Qeverisë së Republikës Sërpska në Srebenicë të enjten, më 23 maj. Seanca e qeverisë u mbajt në prag të seancës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB), në rendin e ditës të së cilës është edhe rezoluta për gjencoidin në Srebenicë. "Kjo nuk është shkëputje. Ndarja paqësore nuk është shkëputje. Ndarja paqësore është e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Ne do të ofrojmë atë. Nëse na konsideroni komb gjencoidal,



që nuk jemi, atëherë nuk kemi pse të jetojmë së bashku", tha Vishkoviç, pa dhënë hollësi të tjera për hapat që do të ndërmarin. Presidenti i RS-së, Millorad Dodik, po ashtu mori pjesë në mbledhjen e ekzekutivit. Rezoluta, e cila propozon që 11 korriku të shpallet Ditë

Ndërkombëtare e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit të Srebenicës, si dhe dënon mohimin e gjenocidit dhe madhërimin e kriminelëve të luftës, u sponsorizua nga tri dhjetë vende. Propozueset zyrtare të saj ishin Gjermania dhe Ruanda. Mbështetje për të, deri më tash,

shprehën të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përveç Serbisë dhe entitetit serb të Bosnjë-Hercegovinës, Republika Sërpska. Zyrtarët e tyre, pavarësisht prej vendimeve të gjykatave ndërkombëtare, mohojnë se në Srebenicë është kryer gjenocid kundër boshnjakëve dhe thonë se atje ka ndodhur një "krim i tmerrshëm". Në korrik të vitit 1995, forcat serbe të Bosnjës vranë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë në Srebenicë. Për gjencoidin e kryer u dënuan më shumë se 50 persona me rreth 700 vjet burg. Në mesin e tyre janë edhe presidenti i kohës së luftës i Republikës Sërpska, Radovan Karaxhiq, dhe komandanti i përgjithshëm i ushtrisë së atëhershme serbe, Ratko

Mlladiq. Të dy ata u dënuan me burgim të përjetshëm. Serbia lloboi në mënyrë aktive kundër miratimit të rezolutës për Srebenicën dhe, një ditë para se të dilte në OKB, Asambleja e Republikës Sërpska miratoi një notë proteste drejtuar vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara, duke kërkuar tërheqjen e rezolutës, edhe përkundër faktit se në dokument nuk përmendet as Republika Sërpska e as Serbia. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë e karakterizoi krimin në Srebenicë si gjenocid në vitin 2007. Gjykata konstatoi se Serbia nuk ishte përgjegjëse për aktin e as bashkëpunëtorë, por deklaroi se ajo nuk bëri asgjë për ta parandaluar atë.

Norvegjia do t'ua ndalojë hyrjen shumicës së turistëve rusë

OSLO, 23 MAJ - Norvegjia do të vendosë kufizime shtesë ndaj turistëve rusë për shkak të luftës në Ukrainë, tha enjten Ministria e Drejtësisë e vendit nordik. Hyrja do të jetë e ndaluar pothuajse për të gjithë turistët rusë, sipas ministrit. Norvegjia, anëtare e NATO-s, e ndan një vijë kufitare gati 200 kilometra të gjatë me Rusinë në Arktik. Ajo vendosi kufizime ndaj

turistëve rusë për herë të parë në vitin 2022, pasi Moskë e nisi pushtimin e paprovokuar dhe të jashtëligjshëm të Ukrainës. "Vendimi për ashpërsimin e rregullores së hyrjeve është në përputhje me qëndrimin e Norvegjisë, për të qëndruar përkrah aleatëve dhe partnerëve në përgjigjen e tyre ndaj luftës agresore dhe të jashtëligjshme të Rusisë kundër Ukrainës", tha

ministria e Drejtësisë e Norvegjisë, Emilie Enger Mehl. Qytetarëve rusë, qëllimi i të cilëve është turizmi dhe udhëtimet e tjera jothelbësore, do t'u ndalohej hyrja. Përjashtime mund të ketë në rastet siç janë, vizitat të familjarët e ngushtë që jetojnë në Norvegji, sipas Ministrit. Vendimi i ri do të hyjë në fuqi më 29 maj.



Kuvendi e ratifikon marrëveshjen me Danimarkën për burgjet

PRISHTINË, 23 MAJ - Kuvendi i Kosovës e ka ratifikuar të enjten një marrëveshje për t'ia lëshuar me qira Danimarkës një burg në qytetin jugor të vendit, Gjilan, në të cilin pritet t'i kryejnë dënimet rreth 300 të burgosur danezë.

Në një seancë me procedurë të përshpejtuar, Kuvendi e miratoi Projektligjin për marrëveshjen me Danimarkën me 86 vota për, 7 kundër dhe asnjë abstenim.

Kosova do t'ia lëshojë Danimarkës me qira rreth 30 qeli të burgut në Gjilan, rreth 50 kilometra larg kryeqytetit Prishtinë, në përputhje me marrëveshjen 10-vjeçare mes dy qeverive, e cila u nënshkrua në prill dhe në maj 2022.

Sipas planit, Kosova do t'i përfitojë rreth 200 milionë euro nga kjo marrëveshje, të cilat do t'i shpenzojë për Shërbimin Korrektues të vendit dhe për energjinë e ripërtërishme.

Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli - e cila e paraqiti Projektligjin para deputetëve për votim - tha se traktati i forcon marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Danimarkës. "Qëllimi është forcimi i mëtuftësishëm i marrëdhënieve ekzistuese të bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Danimarkës, duke marrë parasysh zhvillimet pozitive në sistemin e shërbimit korrektues në Republikën e Kosovës, si dhe përfitimet që Republika e Kosovës do t'i ketë nga ky traktat", tha Rizvanolli.

Danimarka nuk mund të dërgojë të burgosur të dënuar



për terrorizëm dhe krime lufte, e as të burgosur të diagnostikuar me çrregullime të rënda mendore, sipas planit. Kosova dhe Danimarka nënshkruan letër-pëlqim për dërgimin e 300 të burgosurve nga shteti danez në Kosovë në dhjetor të vitit 2021. Në prill 2022, dokumenti u shndërrua në Traktat, por Kosova nuk arriti ta ratifikojë atë deri më 23 maj 2024.

Javën e kaluar Kuvendi dështoi ta kalojë Projektligjin e parë për këtë marrëveshje dhe qeveria e aprovoi menjëherë një Projektligj të njëjtit dhe dërgoi në Kuvend, i cili e ratifikoi atë përfundimisht të enjten.

Me ligjin në Kosovë, marrëveshjet ndërkombëtare mund të ratifikohen vetëm me 80 vota për, apo me dy të tretat e deputetëve.

Çfarë parasheh Traktatit?

Traktati ka kohëzgjatje prej dhjetë vjetësh. Aty parashihet që Danimarka të marrë në shfrytëzim qeli, të vetme dhe të përbashkëta, në burgun e Gjilanit - pjesa lindore e Kosovës.

Në këmbim të kësaj, Kosova parashihet t'i ftojë mbi 200 milionë euro.

Nga shuma 200 milionë euro - sa parashihet të përfitonte

Kosova - 30 milionë planifikohen të shkojnë për energji të ripërtërishme, ndërsa pjesa tjetër për investime në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Danimarka, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes, do t'i dorëzojë Kosovës një tarifë fillestare prej pesë milionë eurosh. Ndërsa pagesa do të bëhet në norma tremujore, gjatë 12 muajve të parë të shfrytëzimit të burgut, në pajtim me numrin e të burgosurve që objekti mund t'i strehojë.

Sipas Traktatit, Danimarka nuk do të dërgojë të burgosur të dënuar për vepra terroriste, të burgosur të dënuar për krime

të luftës dhe të burgosur të diagnostikuar me çrregullime të rënda mendore, të cilët kanë nevojë për kujdes mjekësor jashtë burgut.

Udhëheqësit dhe gardianët në burgun e Gjilanit do të jenë nga shteti i Danimarkës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës. Autoritetet në Danimarkë kanë thënë më herët se kapacitetet e burgjeve të tyre janë mbushur 100 %, pasi numri i të burgosurve është rritur për gati 20 % nga viti 2015.

Haxhiu falënderon deputetët që votuan pro marrëveshjes me Danimarkën për burgjet

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, i ka falënderuar deputetët për votimin e marrëveshjes me Danimarkën për burgjet. Ajo ka thënë se kjo marrëveshje është një dëshmi e besimit dhe respektit reciprok mes dy vendeve. "Falënderoj deputetët e Kuvendit të Kosovës për miratimin e kësaj Marrëveshje të dobishme për Republikën e Kosovës. Kjo marrëveshje është një dëshmi e besimit dhe respektit reciprok mes dy vendeve tona. Ajo do të sjellë përfitimet të ndërsjella dhe do të hapë dyer të reja për bashkëpunime të ardhshme", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

KQZ-ja fillon përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme, ndan 1 milion euro për furnizim me kamera për vendvotime

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 MAJ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar përgatitjet e para për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin e Kosovës. Në mbledhjen e së enjtes, KQZ-ja ka marrë vendim për miratimin e specifikave për furnizim me kamera që do të përdoren në vendvotime për zgjedhjet e ardhshme në Republikën e Kosovës.

Shuma e përgjithshme e planifikuar për këtë aktivitet prokurimi sipas KQZ-së është 1 milion euro.

Për herë të parë KQZ-ja përdori kamerat në vendvotime në procesin për apo kundër largimit të kryetarëve nga funksioni i tyre në komunat

Leposaviq, Zubin-Potok, Zvečan dhe Mitrovicë e Veriut, i cili u mbajt më 21 prill 2024.

Këto kamera KQZ-ja e Kosovës i kishte huazuar nga KQZ-ja e Shqipërisë.

Anëtarë nga radhët e PDK-së, Arianit Elshani, tha se vendosja e kamerave në vendvotime, sipas KQZ-së, ka për qëllim ruajtjen e integritet të procesit zgjedhor.

Ndërsa anëtarë i KQZ-së nga radhët e LV-së, Sami Kurteshi, ngriti për diskutim çështjen nëse mund të bëhet ky furnizim nëse zgjedhjet mbahen së shpejti.

Sipas shpjegimeve që u dhanë në këtë mbledhje, kjo është një procedurë e rregullt prokurimi dhe do të ishte e pamundur që ky proces të përmbillet deri në muajin korrik.





Zgjedhjet e parakohshme: 'Para vjeshtës' po, por si?

PRISHTINË, 23 MAJ - I duan zgjedhjet e parakohshme, por nuk pajtohen se si të arrijnë deri te to. Partitë opozitare në Kosovë mbeten të ndara. Partia Demokratike e Kosovës pajtohet që në zgjedhjet të shkohet përmes shpërndarjes së Kuvendit, por jo edhe Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, të cilat duan fillimisht dorëheqjen e kryeministrit Albin Kurti.

Opsionin e fundit, partia e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje, "nuk e konsideron".

Në përpjekje për të arritur një konsensus, grupet parlamentare u mbledhën në fillim të kësaj jave, por pa sukses.

Mandati i qeverisë aktuale skadon në fillim të vitit të ardhshëm.

Debatin për zgjedhjet të parakohshme opozita ka kohë që e ka nisur, duke e kritikuar Kurtin për keqqeverisje. Por, ai është shtuar nga jave e kaluar, kur Kurti ka takuar kryetarin e PDK-së - partisë së të madhe opozitare - Memli Krasniqi, dhe ka shprehur gatishmëri për të diskutuar për datën e zgjedhjeve.

Kur?

Për PDK-në ajo duhet të jetë sa më parë.

Duke e fajësuar qeverinë e Kurtit për dështimin e Kosovës për t'u bërë pjesë e Këshillit të Evropës, por edhe për "rrethanat e pafavorshme" ekonomike dhe sociale në vend, nënkryetarija e PDK-së, Mimoza Ahmetaj, thotë se pret që gjatë kësaj jave partitë parlamentare të arrijnë një pajtim se si të shkohet në zgjedhje. "Ne jemi të interesuar që sa më parë të shkohet në zgjedhje, do të thotë të mos pritët vjeshtën", thotë Ahmetaj për Radion Evropë e Lirë.

Fundin e qershorit ose fillimin e korrikut e sheh si kohë për zgjedhje edhe nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, por këmbëngul që Kurti, së pari, të japë dorëheqje, pastaj të shpërndahet Kuvendi.

Kjo këmbëngulje, sipas tij, bëhet për faktin se qeveria aktuale duhet të marrë përgjegjësi për dështimet, përfshirë mosanëtarësimin e Kosovës në KIE. "Shpërndarja e Kuvendit është një lloj marrëveshjeje që i ka përfunduar Vetëvendosjen dhe

PDK-në politikisht", sipas tij. Zyrtarë të Aleancës së Ardhmërinë e Kosovës nuk iu përgjigjën interesimit të Radios Evropë e Lirë për këtë temë, por në deklarata të mëhershme kanë thënë se kërkojnë, fillimisht, dorëheqjen e Kurtit, ose një mocion mosbesimi ndaj qeverisë së tij.

Këtë qëndrim e ka përsëritur më 21 maj zyrtari i kësaj partie, Daut Haradinaj, në një intervistë për Televizionin T7 në Prishtinë. "Në rast se thirret një seancë e jashtëzakonshme, ku kërkohet mocion për shpërbërjen e qeverisë, ne jemi të gatshëm ta japim votën", ka thënë ai.

"Opozita do ta gjejë mënyrën për të shkuar në zgjedhje"

Sociologu dhe njohësi i çështjeve politike në Kosovë, Arton Muhaxhiri, thotë se nuk është reale që partitë opozitare të presin që kryeministri Kurti të japë dorëheqje. Sipas tij, ai nuk do ta bëjë këtë për shkak se "nuk dëshiron të ngarkohet me përgjegjësi për gabimet gjatë qeverisjes". "Unë jam i sigurt se

opozita do ta gjejë mënyrën që ta krijojë një mocion mosbesimi [ndaj qeverisë], në mënyrë që të arrihet deri te shpërndarja e Kuvendit, me të cilën, në mënyrë indirekte, do të pajtohej edhe kryeministri Kurti, thotë Muhaxhiri për Radion Evropë e Lirë.

Ai beson se zgjedhjet do të mbahen para vjeshtës, edhe pse thotë se "LDK-ja dhe AAK-ja hezitojnë, për shkak të drojës së mund të jenë të papërgatitura për këtë proces". "Gjasat më reale janë të shkohet tash në zgjedhje, pasi kryeministri Kurti dhe kjo qeveri nuk mund të kenë punë normale me këtë raport të forcave. Pra, do të bëhet e pamundurshme, sepse hendeku mes tij dhe bashkësisë ndërkombëtare do të thellohet", shprehet Muhaxhiri.

Qeveria e Kurtit ka qenë shënjestër e kritikave të komunitetit ndërkombëtar së voni, për shkak të disa hapave që janë cilësuar si të pakoordinuar me të, përfshirë këtu marrjen e vendimit për ta ndaluar përdorimin e dinarit serb në Kosovë e të tjera. Ajo është nën tryshninë e diplomatëve perëndimorë edhe për ta

formuar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Mungesa e hapave në këtë drejtim e ka lënë Kosovën edhe jashtë agjendës së një takimi të Këshillit të Evropës javën e kaluar, ku do të vendosej për anëtarësimin e saj.

Ekspertët besojnë se opioni më real për të shkuar në zgjedhjet e parakohshme është përmes shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës.

Eugen Cakolli, nga Institutit Demokratik i Kosovës, ka shpjeguar më herët për REL-in se për iniciimin e kësaj procedure, kërkohet thirrja e një seance të jashtëzakonshme nga së paku 40 deputetë. Sipas tij, arritja e së paku 80 votave të nevojshme për këtë mocion, "nuk do të ishte e vështirë", nëse merren parasysh numrat që i ka Vetëvendosja, PDK-ja dhe komunitetet pakicë joserbe.

Të pyetur nga REL-i se si do të votonin nëse në rend dite do të dilte shpërndarja e Kuvendit, përfaqësues të pakicave kanë dhënë mendime ndryshe-ndryshe.

Kurti ka thënë më 15 maj se qeveria e tij është "githmonë gati".

Miratohen disa marrëveshje ndërkombëtare, përfshirë atë për kreditë për banimin social

PRISHTINË, 23 MAJ - Deputetët e Kuvendit të Kosovës më 23 maj miratuan disa marrëveshje ndërkombëtare, përfshirë edhe atë për njohjen e kualifikimeve profesionale për infermier, kirurg, veterinar, farmacist dhe mami brenda gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe marrëveshjen për kreditë për projektin për banim social. Sipas ligjit në Kosovë, marrëveshjet ndërkombëtare mund të ratifikohen vetëm me votat e dy të tretave të deputetëve. Marrëveshja e parë e miratuar, e

cila mori 92 vota të deputetëve, ishte ajo për njohjen e kualifikimeve profesionale të sektorit të shëndetësisë.

Kjo marrëveshje u mundëson qytetarëve që në shtetin pritës ta ushtrojnë të njëjtin profesion për të cilin janë kualifikuar në shtetin amë dhe të realizojnë këtë në kushte jo më pak të favorshme sesa në shtetin pritës. Kuvendi, po ashtu, miratoi marrëveshjen e kreditë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe

Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE).

Për këtë marrëveshje votuan 80 deputetë, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Në prezantimin e kësaj marrëveshjeje, ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se kjo kredi është për projektin "banimi social adekuat" dhe kap vlerën 25 milionë eurove.

"Marrëveshja përfshin ngritjen e numrit të njësjive për banim social që mund të bëhet duke rinovuar banesat sociale

ekzistuese, shndërrimin e ndërtesave ekzistuese në banesa të reja sociale, ndërtimin e banesave sociale", tha ministri Murati.

Me kërkesë të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, në rend dite u futën edhe tri marrëveshje ndërkombëtare të cilat u miratuan.

Deputetët votuan për marrëveshjen për bashkëfinancimin për hartimin e projektit për ndërtimin e tunelit në rrugën Tetovë - Prizren, marrëveshjes financiare

ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020 dhe si marrëveshjen ndërkombëtare me Fondin Zhvillimor të OPEC-ut.

Marrëveshjet ndërkombëtare kishin mbetur të bllokuara tash e disa muaj për shkak të mospajtimeve në mes të opozitës dhe pushtetit.

Javën e kaluar ky ngërc ishte tejkaluar duke u votuar disa marrëveshje përfshirë një marrëveshje ushtarake me Turqinë.



Konjufca: Lezha është kryeqyteti i besëlidhjes shqiptare



PRISHTINË, 23 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, mori pjesë dhe mbajti fjalë rasti në festën promovuese të turizmit të qytetit të Lezhës, "Shije Lezhe n'Prishtinë", e cila u mbajti në Sheshin "Zahir Pajaziti" të kryeqytetit.

Në prani të kryetarit të Bashkisë së Lezhës, Pjerin Ndreu, përfaqësuesve të institucioneve qendrore dhe lokale, ambasadorit të Shqipërisë, Petrit Malaj e ambasadorëve të vendeve mike në Prishtinë, si dhe qytetarëve të shumtë, kryetari

Konjufca e konsideroi të veçantë këtë moment ngaqë, siç tha ai, është e zakonshme që Prishtina të shkojë në Lezhë, por nuk është e shpeshtë që Lezha të vijë në Prishtinë.

Kreu i Kuvendit tha se Lezha ka tre lloje të turizmit:

turizmin e plazhit, turizmin historik dhe atë malor. "Krahas turizmit të plazhit, Lezha ka edhe turizmin historik, i cili është shumë i rëndësishëm për shqiptarët, ngado që janë, sepse Lezha është kryeqyteti i besëlidhjes shqiptare, është kryeqyteti i

Gërgj Kastriotit, ku shqiptarët e kanë lidhur besën për liri e për shpëtim. Dhe natyrisht ka turizmin malor, turizmin e natyrës. Mos ta harrojmë se ka edhe një gastronomi të shkëlqyeshme", tha kryetari Konjufca në fjalën e tij.

Bajrami: Qeveritarët kanë shpenzuar mesatarisht 8 800 euro në ditë për ushqim dhe pije

PRISHTINE, 23 MAJ - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka thënë se qeveria Kurti gjatë vitit të kaluar ka shpenzuar 3.2 milionë euro për dreka zyrtare apo mesatarisht 8 mijë e 800 euro në ditë. Për këto të dhëna, ajo

është referuar një raportit financiar të Ministrisë së Financave. Sipas saj, në këtë raport figuron se janë shpenzuar edhe 3.1 milionë euro për mobilie për zyra dhe 139 mijë euro për blerje të telefonave. Ajo i ka quajtur këto

shpenzime luksu derisa ka thënë se "korrupsioni më i madh në qeverinë Kurti" janë tenderët njëburimorë. "Janë 240 milionë euro në tenderët e qeverisë me negocim të drejtpërdrejtë. Andaj, përpas para drejtësisë, partia në pushtet duhet të japë llogari

edhe para qytetarëve që po i varfëron çdo ditë. A ju kujtohet qysh mashtromin kur ishin në opozitë. Thoshin: 'nuk hipim në në xhapa me xhama të zi'. Shihni si kanë ndryshuar, metamorfozë e plotë", ka shkruar Bajrami në "Facebook".



Humbja e madhe nga qeveria e paaftë

U konsultuan me partnerët e jashtëm, por jo edhe me kryetaren e shtetit që është obligim kushtetues. Shpërpjesëtim karagoz!



Hasan MUJAJ

Berlini, Parisi, Roma etj. U konsultuan me partnerët e jashtëm, por jo edhe me kryetaren e shtetit që është obligim kushtetues. Shpërpjesëtim karagoz!

Sipas Kushtetutës së Kosovës, kryetari e shtetit (kryetari i shtetit) ka disa kompetenca kushtetuese të zhvillimit dhe të vrojtimit të politikës së jashtme. Sipas njoftimit të Presidencës, nuk ka pasur konsultim me kryetaren Vjosa Osmani rreth dërgimit të letres nga ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Në këtë rast del në dritë edhe shkelja e Kushtetutës për të cilën (shkelje) ka përgjegjësi ligjore ashtu sikundër dëshmohet edhe mosbashkëpunimi Qeveri-Presidencë madje për çështjet me interes parësor për shtetin.

kur në postet më të larta të shtetit vihen njerëzit pa asnjë ditë përvojë pune! Ministri Gërvalla vuri në dukje se ka prituri vendim pozitiv nga shtetet anëtare, por "nuk u mor parasysh." Konstatim shumë i papërkohshëm vëzhguar nga këndkudrimi i historisë së diplomacisë dhe i politikës ndërkombëtare. Diplomacia do studim e hulumtim veprimi dhe jo të nivelit të letres; qe veprim tejet i papjekur nga performanca dhe kompetenca madje kompetencues për institucionet drejtuese të shtetit.

Qeveria humbi besimin e partnerëve

Letra e ministres, siç u vlerësua edhe nga disa liderë evropianë, shërbeu vetëm si shtysë injorimi, refuzimi e sanksionimit refuzues. Kështu p. sh. ish-drejtori për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Pierre Mirel, në një intervistë për Zërin e Amerikës, ndër të tjera, tha: "Kosova nuk është në gjendje të dorëzojë një projekt, pra jo projektin përfundimtar, por një projekt në Gjykatën Kushtetuese. Kjo nuk është pozitive. Kështu humb besimi i partnerëve!" Aksiomë. Këtë besim vërtet e humbi Qeveria e Kosovës! Por, duhet të mbahet parasysh se nuk është detyrë e lehtë të jesh ministër e (ministër i) Punëve të

Jashtme. Assesi. Për pranimin e posteve të këtij niveli duhet të shërbejë si udhërrëfim edhe kriteri i Sokratit: "Njihe veten!" Nuk ka aq shumë faj zonja Gërvalla; faji i madh qëndron tek ai që i emëron ministrat. Veprimi në vështirësi dhe jo vetëm ky, por edhe shumë veprime të tjera të këtu mund të arsyetohen dhe të vërtetohen nga një mendim metaforik i filozofit të shquar, i prof. të disa universiteteve amerikane, prof. dr. Arshi Pipa: "Qysh mund të dali e bukur nji shtatore kur dalta asht e paprehun." Semantika e këtij citati është shumë e qartë dhe nuk ka mbëhi për zbërthim kuptimi. Ky citat është porosi shumë domethënëse dhe me vlerë të përhershme, sidomos për pozitaz e larta shtetërore.

Këtë kuptim e përforcon dhe e vërteton edhe filozofi amerikan, i dalë nga shkolla pragmatike e Çikagos, Xhon Pirs kur bën fjalë për diplomacinë dhe kishte shkruar: "Diplomacia është art: me njëqind fjalë nuk mund të thuhet çka thuhet me një fjalë." Andaj, kërkohet vëmendje e posaçme përkitazi me emërimin e ministrave dhe ministrave ngase prej zotësisë së veprimeve të tyre varen sukseset e ministrave dhe të qeverisjes ose e kundërta: ministratë e paafta sjellin dështimin e qeverisjes sikundër ndodhi në rastin e mosanëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës!

Vonesa e letres!

Për kohën e dërgimit të letres, për vonesën e saj, me shumë arsye ndërhyri edhe Gerald Knausi: "Kosova nuk do të jetë në agjendën e Këshillit të Evropës, letra erdhi vonë." Mund të shtrohet pyetja: përse nuk u dërgua letra më herët. Dikush duhet ta marrë përgjegjësinë për këtë gabim, i cili jo vetëm që solli mosanëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, por hapi rrugën e vërshimeve të mëdha kritike edhe nga shtetet mirëdashëse të Kosovës. Faktori kohë shpeshherë i ka humbur ose i ka fituar betejat! Por, kështu ndodhi, si vonesa e letres,

Qesëndi e paparë në historinë e diplomacisë. Veprim sa filistun, aq edhe frapant. Diletantizëm politik e komik. Këta pesë përcaktorë të stilit emëror mjaftojnë të dëshmojnë për ta vlerësuar dhe kualifikuar veprimtarinë impulsive e miopike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës si flamurtare e dështimit diplomatik dhe politik të shtetit. Letra shterpë e ministres D. Gërvalla dhe koha e dërgimit të saj kryetarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës janë tregues faktikë të

mosbashkërendimit të tri institucioneve më të larta të shtetit madje për çështjet me rëndësi të veçantë për integrimin e anëtarësimin e Republikës së Kosovës në institucionet ndërkombëtare. Këta tregues apolitikë i dhanë të drejtë BE-së të reagojë: "Smund ta vlerësojmë draftin e paralajmëruar nga Kosova për Asociacionin pa e ditur përmbajtjen." Arsyetimi i ministres se dërgimi i letres u bë në konsultim me partnerët tanë nuk qëndron në këmbë. Jo, Ai u rëzua pikërisht nga disa partnerë si:

Kosova shpreh interesim për bashkëpunim me kompanitë austriake

PRISHTINE, 23 MAJ - Duke vazhduar diskutimet nga takimi paraprak me ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Georg Schnetzer, mbi interesin për bashkëpunim me kompanitë austriake, ministri i Financave, Hekuran Murati, ka zhvilluar një takim me përfaqësuesit e Federatës së Industrisë Austriake për t'i shqyrtuar hapat konkretë në këtë drejtim. Lidhur me këtë, ministri Murati priti të enjten në takim presidentin e Federatës së Industrisë Austriake, Georg

Knill, drejtorin për Tregje dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në këtë federatë, Igor Sekardi, dhe ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Georg Schnetzer. Gjatë takimit, ministri Murati paraqiti disa nga politikat e qeverisë që kanë ndikuar në rritjen e punësimit të grave dhe të rinjve, përfshirë subvencionimin e pagave përmes platformës "Superpuna", bursat për gratë në fushat STEM dhe trajnimet për të rinjtë në teknologji dhe inovacion.

Përveç fuqisë punëtore të kualifikuar, ministri Murati theksoi sektorët e minierave dhe të përpunimit të metaleve si dhe normat e favorshme tatimore, si avantazhe të Kosovës që e bëjnë atë vend atraktiv për investime. Në anën e tij, presidenti Knill shprehi gatishmërinë për ta thelluar më tej bashkëpunimin me Qeverinë e Kosovës dhe vlerësuar potencialin ekonomik dhe mundësitë e shumta që ofron Kosova për investitorët e huaj.



Sërisht dështon votimi i Projektligjit për Shëndetin Riprodhues

PRISHTINE, 23 MAJ - Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta votojë në lexim të dytë Projektligjin për Shëndetin Riprodhues (IVF) gjatë një seance të enjten, më 23 maj, për shkak të mungesës së deputetëve gjatë votimit.

Votimi për këtë projektligj tash e disa muaj ka ngecur tek amendamenti i katërt i propozuar nga deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Visar Korenica.

Amendamenti i katërt nuk kaloi as në seancën e së enjtes, pasi që për të votuar kanë deputet, dy kundër dhe abstenuan 55 nga 120 deputetë sa ka Kuvendi i Kosovës.

Korenica tash e disa muaj kishte kërkuar që prej legjislacionit duhet të largohen tre paragrafë të cilët parashohin se e drejta për riprodhim u takon edhe individëve, përveç çifteve të martuara (burrit dhe gruas).

Si referencë për individë, ai i ka përmendur gratë e pamartuara dhe partnerët e gjinisë së njëjtë.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Korenica, në seancën e 23 majit paraqiti edhe amendamentin e pestë, duke kërkuar që në projektligj të mos jetë individi ai që vendos të ketë



fëmijë, por të jetë vendim i çiftit. "Vetëm çiftet bashkëshortore kanë të drejtë për të vendosur me vullnetin e tyre për të pasur fëmijë dhe assesi individi apo gruaja e pamartuar duke ia muohuar të drejtën fëmijës të ketë baba edhe nënë", tha

Korenica, i cili edhe njëherë kundërshtoi këtë projektligj për formën sesi është aktualisht.

Te votimi për këtë amendament morën pjesë vetëm 59 deputetë dhe, në këtë situatë, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, kërkoi të mos vazhdohej tutje

derisa të ketë "koordinim mes grupeve parlamentare". Kjo është hera e pestë radhazi që partia në pushtet tenton t'i votojë amendamentet e propozuara nga deputeti i Vetëvendosjes, Visar Korenica. Për herë të fundit Kuvendi

kishte tentuar t'i miratojë këto amendamente në seancën e 7 marsit, por kishte dështuar për shkak të mungesës së kuorumit. Në teor të vitit të kaluar, pas shumë përpjekjesh, Kuvendi kishte arritur që me 63 vota për, një kundër dhe katër abstendenie ta miratonte në lexim të parë këtë projektligj.

Ky legjislacion ua mundëson edhe grave të pamartuara të mund të lindin fëmijë përmes metodës të fertilizimit të asistuar, i njohur si IVF, në klinikat publike.

Ky ligj ishte kundërshtuar ashpër nga një pjesë e deputetëve.

Sipas projektligjit, të drejtën e shfrytëzimit të IVF-së e kanë edhe gratë e pamartuara, mbi 18 vjeç, që janë në gjendje të mirë shëndetësore e sociale dhe janë të afta "për fertilizim dhe për përkujdesje prindërore".

Kosova ka një repart të posaçëm për IVF-në në Klinikën e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), por ai nuk është funksional pasi nuk ka pajisjet e nevojshme. Për pajisjet e këtij reparti, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 1.5 milion euro.



Osmani dhe Hovenieri flasin për kërcënimet e vazhdueshme dhe destabilitetin e krijuar nga Serbia

PRISHTINE, 23 MAJ - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim të rregullt ambasadorin e ShBA-së, Jeffrey Hovenier, me të cilin ka diskutuar lidhur me bashkërendimin e agjendës ndërkombëtare, çështje të sigurisë, duke pasur parasysh kërcënimet e

vazhdueshme dhe destabilitetin e krijuar nga Serbia, çështje që kanë të bëjnë me të drejta të komuniteteve joshumicë, përpjekjet e përbashkëta për luftimin e dhunës mbi baza gjinore, si dhe një sërë çështjesh të tjera të interesit të përbashkët.



Abdixhiku dhe Hovenieri hanë drekë, bisedojnë për zhvillimet në vend

PRISHTINE, 23 MAJ - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka njoftuar se të enjten ka pasur një drekë pune të rregullt me ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Ai ka thënë se me ambasadorin amerikan kanë biseduar për zhvillimet në

vend dhe për raportet mes dy vendeve. "Kënaqësi, si gjithëherë, bashkëbisedimi dhe pajtimi për vizionin euroatlantik të Republikës së Kosovës, si dhe ecjen e ngushtë me ShBA-në në të gjitha rrugëtimet tona përpara!", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Pesë projektligje marrin përkrahjen e Komisionit për Integrim Evropian

PRISHTINE, 23 MAJ - Në drejtimin e kryetares Rrezarta Krasniqi, Komisioni për Integrim Evropian ka mbajtur të enjten mbledhjen e radhës. Komisioni në këtë mbledhje u dha mbështetje pesë projektligjeve: Projektligjit për Sport, Projektligjit për Rininë,

Projektligjit për Regjistrin e Pronarëve Përfutues, Projektligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, me amendamentet e komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, si dhe Projektligjit për ratifikimin e

amendamentimit nr. 2 të marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për programin IPA 2016. Komisioni, gjithashtu, shqyrtoi edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e tij.



Partneriteti i Kosovës me ShBA-në është armatimi më i fuqishëm në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes që ka Kosova



Shkruan: Safet GËRXHALIJ

Të orientohemi në zhvillimin ekonomik të vendit, të përmirësohet shëndetësia, të

përmirësohet niveli i arsimit, të avancohet dialogu intern dhe ekstern e të koordinohemi me miq dhe partnerë ndërkombëtarë, të mbështesim sektorin privat e në veçanti sektorin prodhues, të depolitizohet menaxhimi i ndërmarrjeve publike dhe të lihen ato ndërmarrje në duar të profesionistëve e jo të militantëve partiak, të mbështesim funksionimin normal të sistemit të drejtësisë dhe atë të sigurisë,

pra këto duhet të jenë objektivat qeveritare e jo të mendohet se ne jemi qendra e botës dhe se çdo gjë sillet rreth nesh. Me arrogancë pa koordinim me aleatët tanë e me populizëm e patriotizëm folklorik nuk hiqen masat ndëshkuese nga ana e Bashkimit Evropian dhe nuk mund të anëtarësohemi jo vetëm në Këshillin e Evropës por edhe në organizata tjera ndërkombëtare me rëndësi strategjike për ardhmërinë e

Kosovës!

Nga përvoja e kamë kuptuar se pa ndihmën e aleatëve ndërkombëtarë, në veçanti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk do ta kishim shijuar këtë liri, e në trashfin diplomatik asnjë shtet nuk do ta kishte pranuar Republikën e Kosovës si realitet e ndoshta edhe Shqipëria pa ndihmën dhe lobimin e miqve dhe aleatëve. Ballkani Perëndimor, Bashkimi Evropian por edhe bota në

përgjithësi janë të sfiduara nga rryma majtiste dhe radikale. Kosova, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina por edhe Maqedonia e Veriut janë të atakuar në forma të sulmeve hibride nga fryma ruso - serbe. Partneriteti i Kosovës me ShBA-në është armatimi më i fuqishëm në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes që ka Kosova. Të jemi falënderues dhe mirënjohës ndaj atyre që ishin me ne në momentet më të vështira!

Deficiti tregtar i Kosovës në prill arriti në 12.2 për qind



PRISHTINË, 24 MAJ - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e eksport-importhit për muajin prill 2024. Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 12.2 % në prill 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë 2023, përkatësisht 427.5 milionë euro krahasuar me deficitin 381 milionë në vitin 2023, teksa eksporti mbulon importin me 14.6 %.

Eksporti i mallrave në prill 2024 kishte vlerën 73.2 milionë euro, ndërsa importi 500.7 milionë euro që është një rritje 8.8 për qind për eksport, si dhe një rritje

11.7 për qind për import krahasuar me periudhën e njëjtë 2023.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit, 25,2 % e përbëjnë metalele bazë dhe artikujt prej tyre; 14,7 % plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 10,8 % ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,5 % artikuj të ndryshëm të prodhuar; 8,7 % tekstili dhe artikujt e tekstilit; 5,3 % produktet mineralele etj.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore për import, 13,6 % e përbëjnë produktet mineralele; 11,5 % makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11,3 %

mjetet e transportit; 11,2 % ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9,6 % metalele bazë dhe artikujt prej tyre etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në BE arritën 25 milionë euro ose rreth 34.1 për qind e eksporteve të përgjithshme me rritje 27.9 %, ku partnerët kryesorë janë Gjermania (11.4 %), Italia (5 %), Holanda (2.4 %) etj. Importet e Kosovës nga BE-ja ishin rreth 243.4 milionë euro ose 48.6 % e importeve të

përgjithshme, me rritje 22.2 %. Importet me pjesëmarrje më të lartë janë nga Gjermania (13.9 %), Italia (6.9 %), Greqia (6 %) etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s

Eksportet e Kosovës me CEFTA arritën në 32.6 milionë euro ose 44,5 % të eksporteve të përgjithshme, me rritje 20,7 %. Partnerët kryesorë për eksport janë Maqedonia e Veriut (16,6 %), Shqipëria (16 %), Serbia (5,4 %), Mali i Zi (4,8 %). Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 65,5 milionë euro ose 13,1 % të

importeve të përgjithshme, me rënie 16,4 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import janë Shqipëria (5,3 %), Maqedonia e Veriut (4,6 %), Serbia (1,8 %).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 15,6 milionë euro ose 21,4 %, ku partnerët më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin Zvicra (8,4 %) dhe ShBA (3,7 %). Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 191,1 milionë euro ose 38,3 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin Turqia (13,5 %) dhe Kina (12,6 %).

Komisioni për Ekonomi miraton raportin me rekomandime për Projektligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfutur

PRISHTINË, 23 MAJ - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i drejtuar nga nënkryetarja Jeta Statovci, mbajti mbledhjen e radhës

në të cilën shqyrtoi Raportin me Rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfutur. Pas shqyrtimit,

anëtarët e komisionit me shumicë votash miratuan raportin me rekomandime për lexim të dytë për Projektligjin për Regjistrin e Pronarëve Përfutur.



Sovjetikët organizuan 3 grushte shteti në Shqipëri. Çfarë shkruante New York Times në 1982



“Nëse Perëndimi nuk krijon një kordon mbrojtës diplomatik për Shqipërinë, duket e mundshme që ajo përsëri të bjerë nën Bashkimin Sovjetik – një ngjarje që mund të paralajmërojë zhvendosjen më drastike në ekuilibrin e fuqisë Evropiane, që nga Lufta e Dytë Botërore”. Kjo ishte frika më e madhe e shprehur në një analizë të të përditshmes prestigjioze New York Times, në vitin 1982 dhe që bota.al e sjell sot në shqip.

Sipas të përditshmes amerikane, sovjetikët nuk e kanë harruar 1961-shin kur u dëbuan nga shqiptarët. Ata kanë organizuar tre grushte shteti, dhe duke patur parasysh sëmundjen e Enver Hoxhës dhe lajmet për vetëvrasjen e Mehmet Shehut, mund të jenë duke organizuar një të katërt, bashkë me një pushtim nga ajri, toka dhe deti. Sipas kësaj analize, për sovjetikët Shqipëria ishte e rëndësishme për dominimin e Mesdheut, njësoj si Hauai për dominimin e Paqësorit nga SHBA.

Nga Eric MARGOLIS

Shqipëria, vendi më pak i njohur evropian, mund të jetë skena e një ndryshimi drastik në ekuilibrin e fuqisë Lindje-Perëndim. Vlera strategjike e Shqipërisë, megjithëse harrohet praktikisht në Perëndim, është kuptuar plotësisht nga Moskë. Në afërsi të Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë, Shqipëria me dy porte të shkëlqyera të ujërave të thella, në Vlorë dhe Durrës, dominon gadishullin Ballkanik dhe hyrjen në Detin Adriatik. Bregu italian është vetëm 50 milje larg, përtej ngushticës së Otrantos.

Në vitin 1961, Shqipëria u bë i vetmi vend që dëboi me sukses forcat “okupuese” Sovjetike dhe një establishment pro-konsullor. Në atë kohë, lideri i partisë Enver Hoxha, një admirues i madh i Stalinit, prishi papritmas të gjitha lidhjet me Moskën për shkak të

programit të de-stalinizimit të Nikita S. Hrushovit. Rusët sapo ishin duke përfunduar një kompleks instalimesh detare dhe vendqëndrimesh nënujore për nëndetëse në ishullin e gurtë të Sazanit, i njohur si “Gjibraltari i Adriatikut”, në portin e Vlorës. Sazani, dhe bazat e tij ajrore dhe logjistike shoqëruese në Shqipërinë kontinentale, do të kishin qenë baza pararojë, nga e cila Kremli do të përhapte këshilltarë sovjetikë dhe maje duke marrë dy nëndetëse. Megjithëse i indinjuar, Bashkimi Sovjetik nuk ishte në gjendje të organizonte një përgjigje efektive ushtarake sepse 21 vjet më parë, kur Flota e Gjashtë e Shteteve të Bashkuara mbizotëronte në Mesdhe, rusëve u mungonte forca ajrore dhe amfibe me reze

të gjatë veprimi.

Rusët nuk e kanë harruar këtë poshtërim nga një vend me 2.5 milion banorë dhe modeli i veprimtarive antishqiptare të Moskës gjatë dy dekadave të fundit, tregon se rivendosja e kontrollit mbi Shqipërinë është një qëllim i rëndësishëm i strategjisë së madhe të Kremilit.

Provat e prekshme të interesit të Moskës për të përmbytur regjimin e Shqipërisë kanë qenë të qarta. KGB, duke përdorur një kolonë të gjerë të pestë pro-sovjetike në Shqipëri, ka organizuar të paktën tre përpjekje grushte shteti.

Sot, ngjarjet në Shqipëri mund t'i paraqesin Moskës mundësinë që ka prituri me shumë durim. Z. Hoxha, 73 vjeç, raportohet të jetë në gjendje të keqe shëndetësore. Lajmi i radios shqiptare për “vetëvrasjen për shkak të depresionit nervor” të Mehmet Shehut, i dyti në komandë,

sugjeron praninë e presioneve në rritje në Partinë Komuniste Shqiptare, ndërsa dita e lënies së trashëgimitarit afrohet.

Ndjësia e njëhansit të ri për Moskën padyshim që rritet nga izolimi i plotë i Shqipërisë. Amerika kapitaliste është armiku numër 1 i Z. Hoxha, i ndjekur nga Bashkimi Sovjetik. Pas vdekjes së Mao Ce Dunit, Shqipëria futi Kinën, dikur aleatin e saj të vetëm, në një grup me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Sovjetik. Jugosllavët dhe grekët, armiq tradicionalë të shqiptarëve, kanë ende projekte territoriale për Shqipërinë. Në procesin e ruajtjes së pastërisë ideologjike marksiste të vendit të tij, zoti Hoxha e ka lënë atë fare pa miq ose aleatë.

Skenari sovjetik për veprim kundër Shqipërisë mund të jetë i parashikueshëm: një grusht shteti që pason operacionet e suksesshme në Çekosllovakia dhe Afganistan. Ndryshe nga situata në vitin 1961, Bashkimi Sovjetik sot ka forca të bollshme për ndërhyrje me reze të gjatë dhe nuk jeton më me frikë nga Flota e Gjashtë. Forcat ajrore mund të hidhen në Shqipëri, të kapin pistat kryesore të avionëve dhe të sjellin pajisje të rënda dhe forca të blinduara. Forcat amfibe nga skuadriljet e Detit të Zi dhe Mesdheut do të izolonin dhe mbështillin Shqipërinë.

Rezistenca nga ushtria dhe policia prej 50,000 njerëzish e Shqipërisë, do të shtypej shpejt. Shqipëria mund të bëhet baza më e rëndësishme pararojë e Bashkimit Sovjetik, aq e

rëndësishme për ambicien e saj shekullore për të kontrolluar Mesdheun dhe Lindjen e Mesme, ashtu siç është Hauai për dominimin e Paqësorit nga Shtetet e Bashkuara. Pasojat politike të pranisë së Ushtrisë së Kuqe 50 milje nga Italia dhe disa qindra milje në veri të Athinës mund të imagjinojnë kollaj.


Por imagjinata duket se mungon në Uashington. Mungesa e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë që nga Lufta e Dytë Botërore e ka çuar Perëndimin në një lloj amnezie për ekzistencën e saj, dhe dikush pyet veten nëse ka ndonjë plan rezervë për t'u përballur me një krizë atje.

As Shtetet e Bashkuara dhe as Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut nuk kanë mbështetur zyrtarisht pavarësinë e vazhdueshme të Shqipërisë, duke e lënë Moskën me synimin joshës të një çmimi të vlefshëm strategjik, që mund të kapet pa rezikun e një reagimi efektiv Perëndimor. Nëse një regiment ajror Sovjetik do të ulej në aeroportin e Tiranës, përgjigja e mundshme e Uashingtonit do të ishte, “Ku është Tirana?”

Nëse Perëndimi nuk krijon një kordon mbrojtës diplomatik për Shqipërinë, duket e mundshme që ajo përsëri të bjerë nën Bashkimin Sovjetik – një ngjarje që mund të paralajmërojë zhvendosjen më drastike në ekuilibrin e fuqisë Evropiane, që nga Lufta e Dytë Botërore. / The New York Times (1982) – Bota.al

EURO GLASS
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Kuka: Konfirmohen pesë norma olimpike për xhudon e Kosovës

PRG, 23 MAJ - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ndihet krenar me garuesit dhe me garueset e tij. Ai ka konfirmuar se sporti më i suksesshëm i Kosovës do të përfaqësohet me pesë garues në Olimpiadën e Parisit sivjet. Laura Fazliu e fitoi medaljen e bronzit

në atë që konsiderohet si gara e fundit para Lojërave Olimpikë, respektivisht Kampionati Botëror i Xhudos, i cili u mbajt në Abu Dhabi. E Kuka tash e ka fokusin total tek Olimpiada, prej nga synon t'i sjellë medalje të tjera Kosovës, njëjtë siç bëri me

garueset e tij në dy Olimpiadat e fundit, në të cilat ia sollti vendit tonë tri medalje të arta me Majlinda Kelmendin, Nora Gjakovën dhe Distria Krasniqin. "Kosova gjegjësisht Federata e Xhudos përfundoi garën e fundit kualifikuese për Lojëra Olimpikë.

Konfirmohen pesë norma olimpike për Lojëra Olimpikë për federatën tonë. Distria Krasniqi 52 kg, Nora Gjakova 57 kg, Laura Fazliu 63 kg, Loriana Kuka 78 kg, Akil Gjakova 73 kg. Trajner krenar", ka shkruar Kuka në "Facebook".



Trepça, kampione e Kosovës në basketboll

MITROVICË, 23 MAJ - Trepça ka shënuar fitore ndaj Golden Eagle Yllit me rezultat 67-66 në ndeshjen e pestë të finales së "play-off"-it në Superligën e Kosovës në basketboll, duke u shpallur kampion. Suharekasit kanë qenë shumë të mirë në çerekun e parë, duke dominuar nga fillimi për ta mbyllur me rezultat 16-10. Alonzo Verge Jr dhe Jalen Nesbitt e nisën mirë takimin duke shënuar pikë, ndërsa te Trepça pesë lojtarë kishin nga dy pikë. Trepça e fitoi çerekun e dytë me rezultat 20-11, ndërsa pjesa e parë u mbyll me rezultat 30-30, duke treguar se ishte një ndeshje shumë e fortë dhe me pak diferenca. K. Bracy-Davis shkëlqeu në këtë çerek, duke shënuar 9 pikë për Trepçën, ndërsa tek ylli shkëlqeu

Alonzo Verge Jr. Ylli e fitoi çerekun e tretë me rezultat 11-7, për ta mbyllur me rezultat të përgjithshëm 41-37. Se ndeshja do të ishte e fortë dhe me pak diferenca, do ta konfirmonte fillimi i çerekut të katërt. Trepça e ka nisur shumë mirë çerekun e fundit, duke arritur një epërsi prej katër pikësh pas një serie prej 12-4. Pas kësaj serie rezultati shkoi në 49-45 për minatorët. Nga këtu filluan faulet teknike, ku Erion Kastrati mori dy të tilla dhe u përjashtua. Alonzo Verge Jr u kujdes që të mos krijohet epërsi, duke shënuar për 50-49. Darnell Edge, mori minatorët mirë super në minutat e fundit me pikë dhe topa të vjedhur për t'i qarë te fitorja, pasi pikët e Verge Jr e afruan rezultatit në 67-66, por jo mjaftueshëm.



Besa Famgas kualifikohet në finale



PRG, 23 MAJ - Flakrim Beqiraj priti penallti në sekondat e fundit për të ndihmuar Besa Famgasin që të kualifikohet në finale të plejofit në Superligën e Kosovës në Hendboll. Në palestren "Karagaçi" në Pejë, në ambient të bukur sportiv dhe para një numri të madh shikuesish, Besa mposhti Kastriotin (34:33). Me rezultatit e përgjithshëm prej 2:1 në fitore, Besa e Pejës kualifikohet në finale të plejofit. Do të përballlet me Rahovecin. Ashtu si pritej, gjysmëfinalja e tretë në mes të Besës dhe Kastriotit ishte dramë e vërtetë.

Pak sekonda para fundit, Ron Ramadani i Kastriotit u pengua palejueshëm. Gjyqtarët dhanë penallti, ndërsa përgjegjësini për ta gjuajtur atë e mori Deniz Terziqi. Gjuajtjet e tij e priti Beqiraj dhe kështu rezultati mbeti 34:33 për ekipin pejan. Sulmin e fundit të Kastriotit e mundësoi prijta e Liridon Esatit në anën tjetër të fushës. Pas fillimit të barabartë të ndeshjes, pjesa e parë i takoi Kastriotit. Ferizajasiit u shkëputën deri në gjashtë gola, 16:10. Pas pjesës së parë rezultati ishte 18:15 në të mirë të Kastriotit. Vendësit u

kthyen gradualisht në pjesën e dytë. Në 23:23 barazuan në minutën e 40. Më pas u zhvillua ndeshje shumë e fortë. Kastrioti sërish u shkëput në dy gola, madje edhe në tri, 27:24. Besa barazoi në 28:28 e në epërsi prej 29:28 doli në minutën e 49. Më pas Besa kishte avantazh prej dy golash, 30:28, po ashtu prej tri golash, 34:31. Por drama nuk mbaroi deri në fund. Kastrioti kishte rastin për të barazuar, por i mungoi fati. Gjysmëfinalja e zjarrtë i lënd finales së parë në Rahovec, që është të shtunën mbrëma.

Gjimshiti dhe Xhaka, pjesë e formacionit të sezonit në Ligën e Evropës

DUBLIN, 23 MAJ - Dy yjet shqiptarë, Berat Gjimshiti dhe Granit Xhaka, kanë qenë ndër më të vlerësuarit në edicionin 2023/24 të Ligës së Evropës. Atalanta e fitoi trofeun duke mposhtur Bayer Leverkusenin në finale me rezultat 3-0. Kështu, mbrojtësi shqiptar, Gjimshiti, ishte ai i cili u gëzua në fund triumfit dhe ngriti lart

trofeun pasi edhe ishte kapiten i Atalantës. Paraqitjet e tij të mira këtë sezon kanë bërë që Gjimshiti të jetë pjesë e formacionit më të mirë të sezonit nga faqja e specializuar "SofaScore". Gjimshiti ka pasur një notë mesatare prej 7.23 në ndeshjet e Ligës së Evropës, ndërsa Xhaka, i cili gjithashtu është pjesë e

formacionit, ka pasur notë 7.36. Pjesë e formacionit të sezonit ishin edhe yjet e tjerë si Alejandro Grimaldo, Mohammed Kudus, Florian Wirtz dhe Pierre-Emerick Aubameyang. Formacioni i sezonit: Svlair; Clauss, Gjimshiti, Mavraponos, Grimaldo; Xhaka; Kudus, Elliott, Wirtz, Harit; Aubameyang.



Dallasi fiton finalen e parë në Perëndim

DALLAS, 23 MAJ - Ka nisur seria e finaleve edhe në Konferencën e Perëndimit në NBA. Dhe që në sfidën e parë ka pasur një surprizë. Ekipi i Dallas Mavericksit fitoi finalen e parë "play-off" në këtë kah të basketbollit amerikan. Skuadra

teksane mposhti me rezultat 108-105 në sekondat e fundit Minnesotan në fushën e kësaj të fundit, duke udhëhequr 1-0 serinë e takimeve. Një ndeshje e ekuilibruar përgjatë gjithë kohës, me të dyja skuadrat që dhuruan një lojë të mirë.

Minnesota nuk përfitoi nga fakti që luante para publikut të saj, duke lëshuar fitoren në fund të takimit. Luka Donçiq me 33 pikë dhe Kyrie Irving me 30 pikë bënë dallimin në parket për Dallasin, një detyse magjike në fushë. Për Minnesotan,

McDaniels me 24 pikë ishte shënuesi më i mirë takimi. Edhe takimi i dytë mes këtyre dy skuadrave do të luhet në fushën e Minnesotas, sfidë që do të zhvillohet më 25 maj. Në Lindje, Bostoni udhëheq 1-0 ndaj Indinas.



Gjimshiti: Nuk e kisha imagjinuar kurrë këtë sukses

BERGAMO, 23 MAJ - Kapitani i Atalantës në finalen e Ligës së Evropës, të cilën skuadra italiane e fitoi me rezultatit 3-0 ndaj Bayer Leverkusenit, Berat Gjimeshi deklaroi për mediet pas këtij triumfi historik, se e gjitha i duket e pabesueshme. "Është e vështirë të gjesh fjalët tani, as që po e kuptoj se çfarë bëmë. Një sukses kaq i madh, pas finaleve së humbur në Kupën e Italisë, është i pabesueshëm. Megjithatë tani nuk më interesojnë tri finalët e humbura", ka deklaruar Xhaka. Më tej, mbrojtësi i kombëtares shqiptare të futbollit u shpreh se sot e mësoi se do të ishte ai kapitani i Atalantës në këtë përballje dhe se ndihet shumë krenar. "Jam krenar. Sot mësova se do ta mbaj shiritin në krah. Grupi është fantastik. Luajtëm shumë mirë dhe me meritë", ka shtuar kapitani "kuqezi". I pyetur nëse e priste këtë sukses në momentin e parë kur është bashkuar me Atalantan, mbrojtësi deklaroi se nuk e kishte



imagjinuar kurrë. "Nuk do ta kisha imagjinuar kurrë. Kur arrita situata dhe pritshmëritë ishin të ndryshme. Ne po luanim për ta shmangur rënien. Ardhja e Gasperinit solli një filozofi të re. Ai gjithmonë dëshiron t'i përmirësojë lojtarët dhe t'i bëjë

ata të performojnë dhe të japin më të mirën e tyre. Pastaj pas disa viteve fillova të imagjinoj një moment të tillë, ndoshta jo Ligës së Evropës, ndoshta më shumë Kupën e Italisë, por sot e meritojmë të gjithë këtë", ka deklaruar Gjimeshi.

Khaka: Urime, Atalanta! E meritoi trofeun

LEVERKUSEN, 23 MAJ - Granit Xhaka dhe Bayer Leverkusenit kanë përshëmbjen e parë sezonale dhe ajo ka ardhur në finalen e Ligës së Evropës. Kampioni në fuqi i Gjermanisë është mposhtur në finalen e Dublinit me rezultat të thellë 3-0 nga Atalanta e cila fitoi për herë të parë në histori trofeun e Ligës së Evropës. Mesfushori shqiptar Granit Xhaka ishte në fushë për Bayer Leverkusenin, por nuk ishte në ditën e tij më të mirë dhe nuk kishte se çfarë të bënte ndaj Atalantës, skuadër që ishte e mirë në çdo pozicion të fushës. Granit Xhaka ka folur pas ndeshjes, duke përgëzuar skuadrën italiane dhe ka pranuar se asgjë nuk shkoji mirë në finalen e Dublinit. "Nuk ka të bëjë me ecurinë e rezultateve. Ka të bëjë me ndeshjen. Humbëm. Ky është futboll. E përgëzoj



Atalantan. Kaq, Keq që gjërat nuk shkuajnë mirë. Nuk ia dolëm. Por në fundjavë kemi një tjetër finale. E dinim se Atalanta do të na

vendoste në presion. Kemi humbur topin, por do të bëjmë më mirë në fundjavë", ka deklaruar Xhaka.

SHKURT

Lopetegui, trajner i ri i West Hamit

West Ham Unitedi ka njoftuar se spanjollli Julen Lopetegui do të jetë trajneri i tyre i ri, duke zëvendësuar David Moyesin e larguar. Klubi londinez nuk ka qëndruar gjatë duarkryq, pasi ka gjetur menjëherë pasuesin e Moyesit. Bëhet fjalë për 57-vjeçarin spanjoll, Lopetegui, i cili do ta marrë drejtimin e klubit nga sezoni i ri. Është vetë klubi londinez që ka njoftuar emërimin e spanjollit me anë të faqes së tyre zyrtare. "Jemi të lumtur ta njoftojmë emërimin e Julen Lopetegui si trajneri i ri i klubit për meshkuj. Ish-trajneri i Spartjes, Portos, Real Madridit dhe Sevillas do ta nisë zyrtarisht punën më 1 korrik", thuhet në njoftimin e londinezëve.

Zyrtarizohet largimi i Mottas nga Bologna, gati transferimi te Juventus

Thiago Motta nuk do ta drejtojë Bolognan në sezonin 2024/25, teksa njoftimi është bërë zyrtar nga vetë klubi kuqebull. Trajneri italo-brazilian është shumë pranë stolit të Juventusit, që i ka ofruar kontratë trevjeçare. "Këtë mëngjes Thiago Motta i komunikoi klubit synimin e tij për më 30 muaj kontratën me Bologna FC 1909. Duke marrë parasysh vendimin, klubi falënderon trajnerin për punën e jashtëzakonshme të kryer dhe i uron atij fat në vazhdimin e karrierës", thuhet në shënim. Tani fillon numërimi mbrapsht për njoftimin zyrtar të emërimit të Thiago Mottas në krye të Juventusit. Ai është njeriu i zgjedhur prej disa kohësh nga Cristiano Giuntoli për të hapur një cikël të ri pas epokës së Allegrit. Thiago Motta pritet të nënshkruajë me Juventusin deri më 30 qershor 2027 për rreth 4 milionë euro neto në sezon.

Barça në bisedime me Flickun

Barcelona pritet të ndahet me Xavi Hernandezin. Trajneri katalunas muaj më parë kishte deklaruar se do të largohej nga klubi në fund të sezonit, ndërsa pak javë më parë tha se e kishte ndërruar mendjen dhe se do ta vazhdojë përvojën në klubin ku ai është bërë legjendë. Sidoqoftë, deklaratat e tij të fundit nuk i kanë pëlqyer presidentit Joan Laporta, i cili ka vendosur ta shkarkojë atë. E në vend të tij, thuhet se Barça ia ka vënë syrin trajnerit Hansi Flick, me të cilin tashmë kanë nisur negociatat. Edhe pse atë e kërkon edhe Chelsea, trajneri gjerman e ka në mendje Barcelonën. Ai mund ta marrë në dorë ekipin sapo të sqarohet definitivisht çështja me Xavin. Sidoqoftë, Flick mbetet opsioni kryesor për presidentin Laporta.

Gasperni: Kemi shkruar historinë

Atalanta shkroi historinë, duke fituar trofeun e parë evropian, pas triumfit me rezultatit e pastër 3-0 ndaj Bayer Leverkusenit në finalen e Ligës së Evropiane në Dublin. Pas ndeshjes, trajneri Gian Piero Gasperini u shfaq mjaft krenar dhe i lumtur për suksesin, teksa shpjegoi edhe arsyet pse kishte vendosur të luante me tre sulmues, duke befusuar gjermanët. "Padyshim. Mendoj se kemi shkruar historinë, jo vetëm për triumfin, por edhe për mënyrën si fituam. Kemi përsëritur ndeshjet që kemi bërë ndaj Liverpoolit dhe Sporting Lisbonës. E pabesueshme ajo që bënë këta djem. Do të mbetet gjatë në histori. Luajmë shpesh me tre sulmues dhe sonte ishin të gjitha mundësitë për të luajtur në këtë mënyrë. Duhej të ishim të rezikshëm, pasi në finale duhet të fitosh. E dinim që po t'i sulmonim, do t'i vinim në vështirësi dhe kështu ndodhi", ka thënë Gasperini.

Leclerc synon fitoren e parë në Montekarlo

Piloti monogask i Ferrari, Charles Leclerc, nuk ka fituar kurrë në pistën e famshme të Montekarlos. Ai ka garuar 6 herë në këtë pistë që prej vitit 2018, kur debutoi në Formula 1, por e ka përfunduar atë

vetëm në dy raste. Në shumë raste tersi ka përndjekur Leclerc para tifozëve të tij, që nuk ka kapur dot as podiumin në Montekarlo, ndaj këtij herë ai synon një rezultat tjetër.

"Risiti që provuam në Imola shkuan mirë, pasi kemi bërë mjaft përmirësime", ka thënë Leclerc. "Edhe rivalët kanë bërë hapa përpara, por vendimet që kemi marrë në Maranello me inxhinierët më

bëjnë optimist për të ardhmen. Shpresoj që ndryshimet të sjellin një avantazh këtu në Montekarlo. E dua shumë fitoren këtu", u shpreh Leclerc. "Do të provoj të fitoj ditën e diel në Montekarlo. Është

fundjava dhe gara ime e preferuar. Është fantastike të japësh maksimumin në këto rrugë. Gjithçka do të vendoset të shtunën në provat zyrtare, ndaj duhet kujdes", ka deklaruar Leclerc.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushitet Ndërtimore

"Ndërtimi i objektivit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin "Ndërtimi i objektivit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Nr. prot: 2317/23 të datës 03.05.2023, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomandë:
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shikohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmp-h-rks.org>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Telefon: + 381 38 200 32 222

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Real Invest" Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë solare fotovoltaik 2MW në Gurrakoc, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.07.2024 në ora 09:00 në Shtëpinë e Kulturës në Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania "Real Invest" Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKccocSWz39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Real Invest" Sh.p.k. Prishtinë për parkun e energjisë solare fotovoltaik 2MW në Gurrakoc, Istog.

<https://mmp-h-rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria me përgjegjësi të kufizuar 'Eco Sun' L.L.C me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër unik identifikues 811875410.

Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë korporatë, që të paraqiten ne afatën 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavjanje se svi klienti da drustvo sa "Eco Sun" L.L.C, od Prishtine donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811875410 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavjivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "Eco Sun", L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811875410, from Prishtina, has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor - debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Markeleon" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810176265.
- Xhafer Shala shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Hasan Tasini" ish shkolla "Nikolla Tesla" Obiliq.
- Blerina Luhani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Valmira Krasniqi nga Damjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I-VII tw SH.F.M.U. "Kongresi Manastirit" Damjan KK Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershorri deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Rotex Prishtina" Sh.p.k Obiliq në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për prodhimin e pllakave te plastikes, fletëzave, tubave dhe profileve të cilat përdoren për dritare dhe dyer të plastikës në Qylagë, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.07.2024 në ora 10:00 në objektin e komunës së Lipjanit, do të organizohet debat publik nga Kompania "Rotex Prishtina" Sh.p.k Obiliq në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKocccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Rotex Prishtina" Sh.p.k Obiliq për impiantin për prodhimin e pllakave te plastikes, fletëzave, tubave dhe profileve të cilat përdoren për dritare dhe dyer të plastikës në Qylagë, Lipjan.

<https://mmpfi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynn.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Kosovo Glass Recycling & CO L.L.C. Qerim, Gjakovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ricikilimin dhe përpunimin e qelqit & xhamit në Gjakovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.07.2024 në ora 09:30 në objektin e komunës së Gjakovës, do të organizohet debat publik nga Kompania "Kosovo Glass Recycling & CO L.L.C. Qerim, Gjakovë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/76454091339?pwd=Kls28UfwQ8685YqmMKEIvzL30VTa.1>

Meeting ID: 764 5409 1339
Passcode: VkkqHP1

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Kosovo Glass Recycling & CO L.L.C. Qerim, Gjakovë për ricikilimin dhe përpunimin e qelqit & xhamit në Gjakovë.

<https://mmpfi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynn.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

